



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ven. nr. 01 / 222 Dt. 07 / 02 / 2023

Në mbështetje të nenit 15 paragrafi 17 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademike në UKZ, Senati në mbledhjen e XLI të radhës të mbajtur më datë 06.02.2023, mori:

**V E N D I M**

Refuzohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike që Dr. Lindita Loku të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

**A r s y e t i m**

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në mbledhjen e XLI të mbajtur më 06.02.2023, me shumicë të votave ka refuzuar propozimin e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike që të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent kandidatja Lindita Loku.

Senati në mbledhjen e XXXVII të mbajtur më datë 27.10.2022, ka refuzuar propozimin e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe e ka kthyer për rishqyrtim tek Këshilli i njësisë akademike.

Këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit, Senatit i ka sjell të njëjtin propozim. Senati në mbledhjen e XLI të dt. 06.02.2023, ka refuzuar propozimin e FSHK-së për zgjedhjen e kandidatës Lindita Loku, pasi që e njëjta nuk i plotëson kushtet për zgjedhjen në thirrjen akademike profesor asistent, sipas raportit të Komisionit të Studimeve kandidatja nuk i plotëson këto kushte: nuk e ka përvojën e mjaftueshme në mësimdhënie universitare sipas nenit 7.1.5 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademike në UKZ dhe nuk është e fushës përkatëse me pozitën e cila kërkohet në konkurs sipas nenit 7.1.6 po të kësaj rregullore.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në organet e universitetit - është vendim përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

1. Të përmendurës
2. Fakultetit të Shkencave Kompjuterike
3. Arkivit



Kryesuesi i Senatit

Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor